



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1219/4 Prot.

Tiranë, më 18.06.2026

VENDIM

Nr. 16, Datë 18.06.2026

PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS TIP DHE ANEKSET PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT
TË PROJEKTEVE FITUESE TË THIRRJEVE TË RRJETIT EUREKA

Në zbatim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Bordi i Administrimit të AKKSHI në mbledhjen e datës 18.06.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës tip dhe anekset për miratimin e financimit të projekteve fituese të thirrjeve të rrjetit EUREKA (dokumentacioni bashkëlidhur këtij vendimi);
2. Përcjelljen pranë Ministrisë së Arsimit për miratim të kontratës tip dhe anekset për miratimin e financimit të projekteve fituese të thirrjeve të rrjetit EUREKA;
3. Ngarkohet AKKSHI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT | AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Znj. Armela Baka, Kryetar _____
Z. Vasil Tole, Anëtar; _____
Z. Erjon Uka, Anëtar; _____
Znj. Mirela Cami, Anëtar; _____

Znj. Juljana Margariti, Anëtar; _____
Znj. Anisa Subashi, Anëtar; _____
Z. Fatbardh Sallaku, Anëtar; _____
Z. Migel Hidi, Anëtar; _____

KONTRATË

PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË RRJETIT EUREKA

KONTRATË |

PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË RRJETIT EUREKA

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT | AKKSHI



Several handwritten signatures in blue ink are visible at the bottom of the page, indicating the signing of the contract. There are approximately six distinct signatures of varying styles.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. Protokollit	_____, datë __. __. 2026
Projekt-titulli	Green Innovation: Cascade Valorization of Agro-industrial By-products through Zero-Waste Solution (VALORGREEN)
Programi	Eureka Network — Thirrja Multilaterale LinkUp 2025
Nr. i projektit Eureka	E!_____
Financuesi	AKKSHI — Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
Drejtuesi i Projektit	Znj. Ilda Kazani, Universiteti Politeknik i Tiranës
Fondi total AKKSHI	152,428.41 Euro / _____ Lek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PALËT KONTRAKTUESE

E lidhur sot, më datë _____.2026, ndërmjet palëve kontraktuese si më poshtë:

FINANCUESI:

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), person juridik publik, e krijuar me VKM nr. 607, datë 31.08.2016, ndryshuar me VKM nr. 464, datë 31.07.2025, që vepron nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit të Republikës së Shqipërisë, me adresë Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë, në cilësinë e Financuesit dhe Autoritetit Kombëtar Zbatues të Programit Eureka Network për Shqipërinë (National Funding Body), e përfaqësuar nga Znj./Z. _____, Drejtor i Përgjithshëm, autorizuar me Urdhrin Nr. _____, datë _____.2026, me numër letërnjoftimi _____.

dhe

PËRFITUESIT (Konsorciumi Kombëtar):

Roli	Institucioni	Përfaqësuesi Ligjor	Funksioni
Lider Konsorciumi	Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT)	Znj./Z. _____	Rektor
Partner IAL	Universiteti i Tiranës (UT)	Znj./Z. _____	Rektor
Partner Biznes	A Consultant sh.p.k. (NIPT: L02417001F)	Z. Gavrosh Zela	Administrator

Palët bien dakord si vijon:



Kjo kontratë lidhet në bazë të:

- Neneve 109–113 të Ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike";
- Ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026";
- VKM nr. 464, datë 31.07.2025, për ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 607, datë 31.08.2016, mbi krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e AKKSHI-së;
- VKM nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor";
- Vendimit të Bordit të Administrimit Nr. 2, datë 13.02.2025 "Miratimin e detajimit të buxhetit të AKKSHI-së për vitin 2025";
- Udhëzimit Nr. 10/2026 të AKKSHI-së për Programin Eureka Network (Universitet–Biznes);
- Vendimit të Bordit të Administrimit të AKKSHI-së Nr. 12, datë 04.05.2026 "Për miratimin e financimit të projektit fitues të Programit Ndërkombëtar EUREKA, për vitin 2025", Nr. Prot. 372/9.

NENI 2 — OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është financimi nga AKKSHI, në formë granti, i zbatimit të projektit me titull:

"Green Innovation: Cascade Valorization of Agro-industrial By-products through Zero-Waste Solution (VALORGREEN)"

paraqitur nga UPT, UT dhe A Consultant sh.p.k. në kuadër të thirrjes multilaterale Eureka LinkUp 2025, me drejtues projekti Znj. Ilda Kazani (UPT).

NENI 3 — PERIUDHA E ZBATIMIT

Kjo kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga të gjitha palët dhe mbaron me:

- dorëzimin e raportit përfundimtar nga liderët e konsorciumit; dhe
- pranimin dhe miratimin formal të raportit nga AKKSHI.

Projekti nuk mund të fillojë para datës së njoftimit zyrtar të aprovimit nga Sekretariati i Eureka-s. Data zyrtare e fillimit dhe mbarimit të projektit përcaktohet në Marrëveshjen e Konsorciumit (Consortium Agreement) ndërmjet partnerëve ndërkombëtarë, e cila është dokumenti bazë operacional i projektit Eureka dhe bashkëlidhet si Aneks 4 i kësaj kontrate.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENI 4 — SHUMA DHE MËNYRA E FINANCIIMIT

Bazuar në Vendimin e BA të AKKSHI-së dhe Udhëzimin Nr. 10/2026, AKKSHI mbështet financiarisht zbatimin e projektit me shumën totale të mëposhtme, sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në ditën e pagesës:

Partneri	Roli	Shuma (Lek)	Ekviv. (€)
Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT)	Lider Konsorciumi	_____	39,211.00
Universiteti i Tiranës (UT)	Partner IAL	_____	82,882.00
A Consultant sh.p.k.	Partner Biznes	_____	30,335.41
TOTALI		_____	152,428.41

Shumat në Euro janë ato të miratuara me Vendimin e BA Nr. 12, datë 04.05.2026. Shuma ekuivalente në Lek llogaritet nga financa e AKKSHI-së sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së pagesës dhe plotësohet në tabelën e mësipërme përpara lëvrimit të fondeve.

Fondi i grantit i kalon llogarisë zyrtare të drejtuesit të konsorciumit (UPT), i cili bën ndarjen e fondeve tek UT dhe A Consultant sh.p.k. brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e fondeve, me urdhër-pagese ose mekanizëm tjetër financiar ligjërish të vlefshëm.

Raporti i financimit të projektit respekton tavanet e bashkëfinancimit sipas llojit të partnerit, siç përcaktohet në pikën 4.2 të Udhëzimit Nr. 10/2026:

- Deri në 80% për bashkëpunim IAL-sipërmarrje mikro/të vogla dhe IAL-institute kërkimore;
- Deri në 75% për bashkëpunim IAL-sipërmarrje të mesme;
- Deri në 65% për bashkëpunim IAL-sipërmarrje të mëdha.

ENI 5 — DETYRIMET E KONSORCIUMIT KOMBËTAR

5.1 Detyrimet e Liderit të Konsorciumit (UPT)

- Të veprojë si ndërmjetës financiar i vetëm midis AKKSHI-së dhe partnerëve të tjerë, duke kthyer tek ata fondet brenda 10 ditëve;
- Të koordinojë raportimin teknik dhe financiar ndaj AKKSHI-së dhe Sekretariatit të Eureka-s;
- Të njoftojë menjëherë AKKSHI-në për çdo ngjarje që rrezikon realizimin e projektit.

5.2 Detyrimet e të gjithë Përfituesve (IAL dhe Biznes)

- Të zbatojnë projektin sipas formularit të aplikimit, buxhetit dhe planit financiar të miratuar;
- Të kthejnë fondet e pashpenzuara në buxhetin e shtetit brenda 15 ditëve pas përfundimit të projektit;
- Të garantojnë funksionimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin për qëllime kërkimore të teknologjisë së financuar për jo më pak se 5 vite pas mbarimit të projektit;



- Të dorëzojnë raportet (të ndërmjetme dhe përfundimtare) teknike dhe financiare sipas Nenit 7;
- Të respektojnë Kodin e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe legjislacionin e pronësisë industriale.

5.3 Detyrimet specifike të Partnerit Biznes (A Consultant sh.p.k.)

Partneri biznes, si anëtar i plotë i konsorciumit kombëtar, ka detyrimet e mëposhtme:

- Të sigurojë bashkëfinancimin e vet sipas raportit të përcaktuar në Marrëveshjen e Konsorciumit dhe buxhetin e miratuar;
- Të japë kontributin teknik dhe operacional sipas aktiviteteve dhe zërave buxhetorë që i janë caktuar;
- Të nënshkruajë Marrëveshjen e Bashkëpunimit me IAL-të para fillimit të projektit (Aneks 5 i kësaj kontrate);
- Të respektojë të gjitha detyrimet financiare dhe raportimin sipas Marrëveshjes së Konsorciumit;
- Të garantojë lirinë për të vepruar (freedom to operate) mbi rezultatet e projektit të destinuara për komercializim.

NENI 6 — DETYRIMET DHE ROLI I AKKSHI-SË

6.1 Roli institucional

AKKSHI vepron në këtë kontratë në dy kapacitete të ndryshme e komplementare:

- Si Financues — organ shtetëror që lëshon grantin nga buxheti i shtetit, sipas Vendimit të BA Nr. 12, datë 04.05.2026;
- Si Autoritet Kombëtar Zbatues (National Funding Body) i Programit Eureka Network për Shqipërinë — ndërmjetëson ndërmjet konsorciumit shqiptar dhe Sekretariatit ndërkombëtar të Eureka-s, dhe garanton zbatimin e rregullave të programit ndërkombëtar.

6.2 Detyrimet e AKKSHI-së ndaj Përfituesve

AKKSHI detyrohet:

- Të lëshojë grantin e miratuar sipas shumave dhe afateve të parashikuara në Nenin 4, pas plotësimit të kushteve të nënshkrimit;
- Të njoftojë konsorciumin për çdo kërkesë monitorimi ose auditimi me të paktën 5 ditë pune paraprake, me përjashtim të rasteve të kontrollit të jashtëzakonshëm;
- Të shqyrtojë raportet e ndërmjetme dhe përfundimtare brenda 30 ditëve pune nga dorëzimi dhe të japë feedback zyrtar;
- Të ruajë konfidencialitetin e informacioneve teknike dhe tregtare të konsorciumit të marra gjatë monitorimit;
- Të njoftojë konsorciumin për çdo ndryshim të rregullave të programit të komunikuar nga Sekretariati i Eureka-s, brenda 10 ditëve pune nga marrja e njoftimit;
- Të veprojnë si pikë kontakti kombëtare (National Contact Point) e konsorciumit shqiptar me Sekretariatit ndërkombëtar të Eureka-s gjatë gjithë periudhës së zbatimit.



6.3 Kufizimet e AKKSHI-së

AKKSHI nuk ndërhyt në vendimet teknike dhe shkencore të konsorciumit brenda fushëveprimit të miratuar të projektit, nuk kërkon ndryshime thelbësore pa konsultim me Sekretariatit e Eureka-s dhe pa miratim të konsorciumit ndërkombëtar, dhe nuk pretendon pronësi intelektuale mbi rezultatet e projektit përtej të drejtës së parashikuar në Nenin 9.

NENI 7 — TË DHËNA BANKARE

Transferimi i fondeve kryhet vetëm në llogarinë bankare zyrtare të UPT si lider i konsorciumit:

Institucioni	Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) — Lider Konsorciumi
Emri i përfituesit	Universiteti Politeknik i Tiranës
NIPT	_____
Kodi i institucionit	_____
Emri i Bankës	_____
Nr. llogarie (Lek)	_____
IBAN	_____
Distrikti / Kodi degës thesarit	_____

Shënim: Fondet destinuar për A Consultant sh.p.k. transferohen nga UPT sipas Marrëveshjes Bashkëpunuese (Aneks 5), me faturë/kontratë shërbimi, duke respektuar kuadrin ligjor të prokurimit dhe kontabilitetit. Kompania private nuk disponon llogari thesari dhe nuk mund të jetë përfituese direkte nga buxheti i shtetit.

NENI 8 — RAPORTIMI

7.1 Raportimi i ndërmjetëm

Pas gjysmës së periudhës së projektit, drejtuesi i projektit dorëzon në AKKSHI raportin teknik dhe financiar të ndërmjetëm, sipas formatit standard të AKKSHI dhe kërkesave të Sekretariatit të Eureka-s.

7.2 Raporti përfundimtar

Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune pas përfundimit të projektit, drejtuesi dorëzon 2 kopje në AKKSHI:

- Raporti përshkrues teknik (sipas formatit AKKSHI/Eureka);
- Raporti financiar, i nënshkruar nga drejtuesi i projektit, financieri, administratori dhe rektori i UPT;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Produktet e realizuara: artikuj shkencorë, monografi, prezantime, prototipe, analiza laboratorike, databaza etj.;
- Një përmbledhje e rezultateve të projektit në gjuhën angleze për publikim;
- Një video e rugëtimit dhe zbatimit të projektit.

7.3 Procedura e shqyrtimit

AKKSHI shqyrton raportin brenda 30 ditëve pune nga dorëzimi. Nëse ka parregullsi, njofton përfituesin brenda 10 ditëve pune për plotësim/korrigjim. Projekti konsiderohet i mbyllur vetëm pas konfirmimit zyrtar të AKKSHI-së.

NENI 9 — TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI I FINANCIMIT

Përfituesit detyrohen:

- Të sigurojnë transparencë të plotë mbi zbatimin e projektit dhe përdorimin e fondeve;
- Të publikojnë në faqet e tyre zyrtare: përshkrimin e projektit, burimin e financimit dhe rezultatet kryesore;
- Të citojnë qartë mbështetjen financiare të AKKSHI-së dhe Ministrisë së Arsimit në çdo material shkencor, promovues ose informues;
- Të përdorin logon dhe identitetin vizual të AKKSHI-së sipas udhëzimeve të saj;
- Të vendosin mbishkrimin: "Mundësuar me mbështetjen financiare të AKKSHI — Ministria e Arsimit, në kuadër të projektit Eureka 2025" në të gjitha materialet e projektit;
- T'i lejojnë AKKSHI-së të publikojë emrin e përfituesit, titullin dhe rezultatet e projektit për qëllime institucionale.

NENI 10 — PRONËSIA INTELKTUALE DHE SHFRYTËZIMI TREGTAR

9.1 Parimi i Eureka Network

Programi Eureka Network ka si qëllim themelor mbështetjen e projekteve me potencial tregtar dhe komercializim. Prandaj, kufizimet mbi shfrytëzimin tregtar të rezultateve janë të papajtueshme me natyrën e programit dhe me Thirrjen Multilaterale Eureka LinkUp 2025.

9.2 Pronësia e rezultateve

Pronësia e të drejtave të pronësisë intelektuale të gjeneruara gjatë projektit rregullohet si vijon:

- Si rregull i përgjithshëm, çdo rezultat i takon partnerit që e ka gjeneruar atë;
- Rezultatet e gjeneruara bashkërisht nga dy ose më shumë partnerë janë pronë e përbashkët; mënyra e administrimit të tyre (autorizime, ndarje fitimesh) rregullohet me Marrëveshjen e Konsorciumit;
- Pronësia e rezultateve dhe rregullimi i plotë i të drejtave intelektuale midis partnerëve të konsorciumit kombëtar dhe ndërkombëtar zgjidhet me marrëveshje konsensuale, sipas seksionit 5 të udhëzimeve Eurostars/Eureka për Consortium Agreement;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- AKKSHI gëzon të drejtën e përdorimit jokomercial të rezultateve shkencore (botime, raporte, prezantime) për qëllime institucionale, informimi dhe raportimi.

9.3 Shfrytëzimi tregtar

Partnerët e konsorciumit, në veçanti partneri biznes (A Consultant sh.p.k.), kanë të drejtë të shfrytëzojnë tregtarisht produktet, shërbimet dhe proceset e zhvilluara gjatë projektit. Ky shfrytëzim:

- Nuk kërkon autorizim paraprak nga AKKSHI, me kusht që aktivitetet tregtare të mos bien ndesh me legjislacionin shqiptar dhe rregullat e programit Eureka;
- Duhet të respektojë parimin e lirisë për të vepruar (freedom to operate) dhe të mos cenojë të drejtat e palëve të treta;
- Duhet të jetë i dokumentuar dhe i raportuar si pjesë e ndikimit të projektit në raportin përfundimtar;
- Nuk ndikon negativisht mbi detyrimet kontraktuale të partnerëve ndaj AKKSHI-së.

9.4 Mbrojtja e rezultateve dhe diseminimi

Partnerët detyrohen të vlerësojnë nevojën për mbrojtje të rezultateve (patentim, model utility, sekret tregtar etj.) dhe të njoftojnë partnerët e tjerë me të paktën 30 ditë para çdo diseminimi të planifikuar. Çdo partner mund të kundërshtojë brenda 15 ditëve nëse interesat e tij legjitime rrezikohen.

Publikimet shkencore janë subjekt i parimit të Open Access, sipas standardeve të Eureka Network.

NENI 11 — PËRGJEGJËSIA E PËRFITUESIT

- Përfituesit janë subjekte përgjegjëse ligjërshisht për zbatimin me efektivitet të projektit;
- AKKSHI nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtime apo ankesa të shkaktuara nga dhe nëpërmjet projektit;
- Nëse projekt realizimi haset me vështirësi, liderit i konsorciumit njofton menjëherë AKKSHI-në dhe dakordëson një kalendar të përditësuar;
- Veprimtaria financiare e përfituesve gjatë zbatimit të projektit është subjekt i auditimit të institucioneve kompetente;
- Përfituesit detyrohen të zbatojnë legjislacionin e prokurimit publik për çdo shpenzim brenda projektit.

NENI 12 — MONITORIMI DHE KONTROLLI

- Përfituesi i përgjigjet brenda 10 ditëve pune çdo kërkesë monitorimi nga AKKSHI;
- AKKSHI ka të drejtë akses në institucionet përfituese pas njoftimit paraprak;
- Përfituesi mban të gjithë dokumentacionin financiar dhe teknik të projektit për të paktën 5 vite pas mbarimit (standartet Eureka kërkojnë 5 vite, jo 3);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Çdo institucion me kompetencë ligjore kontrolli mbi shpenzimet publike ka të drejtë akses në dokumentacion.

NENI 13 — NDRYSHIMET E KONTRATËS

- Ndryshimet thelbësore kryhen vetëm pas miratimit nga BA i AKKSHI-së, me kërkesë zyrtare të motivuar nga konsorciumi;
- Kërkesa për shtyrje të projektit paraqitet të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para përfundimit të projektit — sipas pikës 4.1/d të Udhëzimit Nr. 10/2026;
- Ndryshimet buxhetore lejohen deri në 10% të fondeve, vetëm brenda të njëjtit zë dhe me miratimin paraprak të AKKSHI-së, në konsultim me Sekretariatën e Eureka-s;
- Çdo ndryshim i personelit kryesor njoftohet me shkrim AKKSHI-së;
- Çdo ndryshim tjetër bëhet me akt shtesë të nënshkruar nga të gjitha palët.

NENI 14 — NDËRPRERJA E KONTRATËS

Kontrata mund të ndërpritet kur:

- Kontrata përfundon rregullisht sipas Nenit 3;
- Konsorciumi nuk zbaton projektin sipas cilësisë dhe sasisë të parashikuara;
- Institucionet shtetërore audituese konstatojnë shkelje ligjore të pranuara nga AKKSHI;
- Përfituesi shkel detyrimet e kësaj kontrate ose legjislacionin shqiptar;
- Vjen Forca Madhore, sipas Nenit 18.

NENI 15 — SHPENZIMET E PALEJUESHME

Shpenzimet e mëposhtme janë të palejueshme:

- Shpenzime jashtë buxhetit të miratuar nga BA i AKKSHI-së;
- Borxhe, interesa bankare, provigjone për humbje dhe gjoba;
- Konvertim valutor me humbje;
- Shpenzime TVSH kur ky nuk është kosto neto e projektit;
- Dhurime;
- Financim i partive politike apo organizatave fetare;
- Përfitime për anëtarë të Bordit, stafin ose të afërmit e tyre;
- Veprime në kundërshtim me legjislacionin shqiptar ose rregullat e Eureka-s.

NENI 16 — SANKSIONET

Moszbatimi i detyrimeve sjell pasojat e mëposhtme të përshkallëzuara:

Shkelja	Pasoja
Mosrespektim afatesh raportimi	Paralajmërim → ndërprerje financimi → përjashtim 3-vjeçar nga thirrjet (mbi partnerin shkelës)
Shpenzime të palejueshme (Neni 14)	Kthim i shumës brenda 7 ditëve pune



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shkelje ligjore/etike	Kthim i të gjithë grantit deri në momentin e konstatimit
Ndërprerje realizimi pa justifikim	AKKSHI i drejtohet gjykatës kompetente për rikuperim fondesh

Shënim i rëndësishëm mbi sanksionin e përjashtimit 3-vjeçar: Sanksioni i aplikohet vetëm partnerit të konsorciumit i cili ka kryer shkeljen konkrete, dhe jo të gjithë konsorciumit në tërësi, me përjashtim të rastit kur Bordi i AKKSHI-së vendos ndryshe bazuar në rrethanat specifike.

NENI 17 — ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

Mosmarrëveshjet midis palëve zgjidhen si vijon:

- Palët kanë 30 ditë afat për zgjidhjen me mirëkuptim të çdo konflikti.
- Nëse brenda kësaj periudhe nuk arrihet marrëveshje, palët i drejtohen gjykatës kompetente shqiptare.
- Konfliktet që kanë lidhje me marrëveshjen e konsorciumit ndërkombëtar rregullohen sipas klauzolës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të parashikuar në atë marrëveshje (Aneks 4).

NENI 18 — KONFIDENCIALITETI

Të gjitha informacionet teknike dhe financiare të shkëmbyera gjatë zbatimit të projektit konsiderohen konfidenciale dhe nuk mund të ndahen me palë të treta pa miratimin me shkrim të palës pronare të informacionit.

Detyrimi i konfidencialitetit mbetet në fuqi gjatë periudhës së projektit dhe 5 (pesë) vite pas mbarimit të tij. Ky afat është në përputhje me standardet Eureka/Eurostars.

NENI 19 — FORCA MADHORE

Nuk konsiderohet shkelje e kontratës moszbatimi i detyrimit që vjen si pasojë e forcës madhore (ngjarje të paparashikuara, të paevitueshme dhe të jashtme nga vullneti i palëve). Pala e goditur njofton palën tjetër brenda 5 ditëve pune dhe dakordëson masat e nevojshme. Nëse forca madhore zgjat mbi 3 muaj, çdo palë mund të kërkojë ndërprerjen e kontratës.

NENI 20 — ANEKSET DHE DOKUMENTET INTEGRALE

Anekset e mëposhtme janë pjesë integrale dhe juridikisht detyruese e kësaj kontrate:

Nr.	Titulli i Aneksit	Funksioni
Aneks 1	Formulari i Plot i Projekt Propozimit	Aplikimi teknik i miratuar
Aneks 2	Buxheti i miratuar nga Bordi i Administrimit	Plani financiar detajues



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Aneks 3	Kalendari i aktiviteteve të projektit	Plan pune sipas fazave
Aneks 4	Marrëveshja e Konsorciumit (Consortium Agreement)	Dokumenti bazë ndërkombëtar i projektit
Aneks 5	Marrëveshja e Bashkëpunimit IAL-Biznes	Raporti ndërmjet UPT/UT dhe A Consultant
Aneks 6	Lista e Background IP	Njohuritë paraekzistuese të çdo partneri

Në rast mospërputhjeje mes tekstit të kontratës dhe anekseve, prevalon kjo kontratë, me përjashtim të Marrëveshjes së Konsorciumit ndërkombëtar (Aneks 4) e cila rregullohet nga legjislacioni i rënë dakord nga partnerët ndërkombëtarë.

NENI 21 — DISPOZITA TË NDRYSHME

- Ndryshimet e kësaj kontrate bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të gjitha palët;
- Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis palëve lidhur me objektin e saj;
- Çështjet e parashikuara specifikisht në këtë kontratë i referohen akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- Kjo kontratë hartohet dhe lidhet në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe: 2 për AKKSHINë dhe nga 1 për secilin përfitues.

Pasi u lexua nga palët, kontrata nënshkruhet me vullnetin e lirë të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NËNSHKRIMET

<p>Për AKKSHI</p> <p>Znj./Z.: _____</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm: _____</p> <p>Data: _____</p> <p>Vula: _____</p>	<p>Për Universitetin Politeknik të Tiranës (Lider)</p> <p>Znj./Z.: _____</p> <p>Rektor: _____</p> <p>Data: _____</p> <p>Vula: _____</p> <p>Drejtuuesi i Projektit: _____</p> <p>Znj. Ilda Kazani: _____</p>
<p>Për Universitetin e Tiranës</p> <p>Znj./Z.: _____</p> <p>Rektor: _____</p> <p>Data: _____</p> <p>Vula: _____</p>	<p>Për A Consultant sh.p.k.</p> <p>Z. Gavrosh Zela: _____</p> <p>Administrator: _____</p> <p>Data: _____</p> <p>Vula: _____</p>

AKKSHI — Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37, Tiranë | www.akkshi.gov.al